



1.8 miliardë lekë për bujqësinë - Denaj: Mbështetje për skemën kombëtare të naftës dhe të blegtorisë

Faqe 2



Tajani: Përfshijmë Bujqësinë në investime, vijojmë importin e vajit shqiptar të ullirit

Faqe 4



Skema Kombëtare, AZHBR subvencionon 1219 fermerë për inputet bujqësore

Faqe 6



# AGROBIZNESI



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.  
Tel: +355 4 2 251 910 /911  
Email: info@fedinvest.al  
kontakt@fedinvest.al  
www.fedinvest.al

## BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445  
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i parë i muajit tetor 2023

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 471  
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

## MINISTRJA DENAJ TAKIM ME PËRFAQËSUES TË KASH-IT

**NË FOKUS TË TAKIMIT: PROCESI I KOOPERIMIT DHE KOORDINIMIT; FUSHA E MEKANIZIMIT, INOVACIONIT DHE DIGJITALIZIMIT; FUSHA E FINANCIMIT DHE DISBURSIMIT TË FONDEVE GRANT, SI DHE FUSHA E PËRMIRËSIMIT TË LEGJISLACIONIT DHE AKTEVE NËNLIGJORE**

*Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj gjatë një bashkëbisedimi që zhvilloi në ambientet e MBZHR-së, me përfaqësues të KASH-it, vuri në dukje se, Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar është një partner i rëndësishëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në shumë procese konstruktive në detyrat e bujqësisë*

### RISI ALBANIA NJË PROJEKT I AGJENCISË ZVICERANE SDC

Modeli i suksesshëm në Tiranë i këshillimit për arsimim dhe karrierën, tani edhe në tri bashki të tjera



Qeveria Zvicerane kontribut për zhvillimin rural në Shqipëri



Faqe 2

### AGROTURIZËM

Strategjitë për të ndërtuar një biznes të qëndrueshëm - RisiAlbania njofton për organizimin e nje serie webinaresh

Faqe 10



Denaj: Sigurimi në bujqësi, i rëndësishëm në kushtet e ndryshimeve klimatike



Faqe 7

### NDRYSHIMET KLIMATIKE

Raporti i Bankës Botërore, bujqësia një nga sektorët më të prekur nga ndryshimet klimaterike



Faqe 7

### OPINION



### Ekologjia e Institucioneve të Bujqësisë

Prof. Ass. Dr. Enver Isufi  
Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike

Faqe 11

### TITUJ TË TJERË

- Denaj: Të integrojmë në bujqësi e blegtori teknologjinë e informacionit të përparuar Fq. 5
- Deda: AKU, platformë bashkërendimi për sigurinë ushqimore Fq.12
- Gratë rurale kultivojnë ushqim cilësor për të gjithë Fq. 5
- Krahina e Oparit - Vatër e origjinës së shumë specieve bimore Fq.13

## RISI ALBANIA

## FINANÇIM

# Modeli i suksesshëm në Tiranë i këshillimit për arsimim dhe karrierën, tani edhe në tri bashki të tjera

Zyra e Këshillimit të Karrierës - Bashkia Tiranë, ka rezultuar një projekt mjaft pozitiv dhe i frytshëm, në orientimin e nxënësve drejt zanateve dhe promovimin e arsimit profesional për punësim të sigurt.

Falë mbështetjes së projektit RisiAlbania, zyra e këshillimit dhe fushata e informimit kanë dhënë rezultate konkrete në rivitalizimin e arsimit profesional dhe rritjen e interesit tek të rinjtë e të rejtat që përfitojnë nga një vendimmarrje e mirëinformuar për karrierën, çka sjellë mirëqenien e tyre shoqërore e financiare. Gjithashtu punëdhënësit përfitojnë nga të rinjtë me të mirëinformuar dhe të mirëkualifikuar, që hyjnë në tregun e punës.

ofrimin e shërbimeve cilësore të orientimit në karrierë për të rinjtë e të rejtat.

Gjatë këtyre ditëve, pjesëmarrësit u thelluan në bazat e këshillimit të karrierës dhe u angazhuan në diskutime të hapura për të ndërvepruar dhe njohur më mirë me njëri-tjetrin

Zyra do të bashkëpunojë me institucionet publike, bizneset dhe shoqatat e të rinjve për të rritur në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e shërbimit. Grupmosha të ndryshme do të marrin shërbime të specializuara: edukim për karrierë për nxënësit parauniversitarë, këshillim në grup dhe në mënyrë individuale dhe trajnim për zhvillimin e karri-

tit 2023 janë zhvilluar politika dhe procese të brendshme për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e kualifikimeve profesionale, në këtë kontekst, standardet e kualifikimit dhe skeletkurrikulat tashmë po zhvillohen në përputhje me një metodologji bashkëkohore e cila merr në konsideratë parimet dhe kriteret e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe bazohen në kontributin aktiv të sektorit privat.

Riorganizimi ka sjellë që aktualisht arsimit profesional të ofrohet në 30 shkolla publike të arsimit profesional, ku ofrohen 26 drejtime mësimore dhe 87 profile. Trendi i regjistrimeve në klasat e 10-ta vazhdon

# 1.8 miliardë lekë për bujqësinë - Denaj: Mbështetje për skemën kombëtare të naftës dhe të blegtorisë

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj nëpërmjet një njoftimi në faqen e saj zyrtare, bëri të ditur se, në Aktin Normativ për ndryshimet në buxhetin e vitit 2023 qeveria ka alokuar një fond shtesë prej 1.8 miliardë lekësh mbështetje për bujqësinë dhe blegtorinë shqiptare.

Denaj informoi se ka filluar menjëherë puna për të vënë në zbatim vendimin e Qeverisë për mbështetjen e të gjithë aplikuesve në skemën kombëtare të naftës dhe të blegtorisë.

“Kjo mbështetje shpreh edhe një herë angazhimin e plotë të Qeverisë Rama për zh-

villimin e bujqësisë”, u shpreh Denaj.

Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR) dhe Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (AREB) janë në punë intensive së bashku me fermerët dhe pushtetin vendor për ta realizuar këtë proces brenda vitit.

# Kryeministri Rama: Do të këtë një riorganizim të administrimit të fondeve të BE-së për bujqësinë

Do të këtë një riorganizim të administrimit të fondeve të BE-së për bujqësinë. Këtë bëri me dije nga Kroacia Kryeministri Edi Rama gjatë një konference me homologun kroat.

Kreu i qeverisë tha se i ka kërkuar kryeministrin kroat me shumë mbështetje për procesin e negociatave në BE, për turizmin, sigurinë kibernetike, dhe në mënyrë specifike ndihmë për të trajtuar situatën me fondet për bujqësinë, pasi një rast të ngjashëm ka pasur edhe Kroacia.

“Ne kemi përfutur tani falë mbështetjes së qeverisë kroate një mbështetje direkte për procesin e negociatave

në Bashkimin Europian, dhe po ashtu duam të përfitojmë sa më shumë mbështetje me dije për turizmin, për sigurinë kibernetike, për ndihmën aktive në funksion të punësimin, si edhe për të trajtuar në mënyrë specifike raste, siç është rasti që ne kemi aktualisht lidhur me disa korrektive të domosdoshme që do bëjmë në fushën e administrimit të fondeve të BE për bujqësinë, sepse një raste të ngjashëm ka pasur edhe Kroacia dhe na intereson të mësojmë për adresimin struktural që ka bërë qeveria kroate ka bërë në këtë drejtim.

Nga ana tjetër kemi prekur temën e një sektori strategjik

siç është energjia e kombinuar me infrastrukturën, sepse së bashku me Kroacinë jemi pjesë e të njëjtit plan të korridorit Adriatiko-Jonian. Kryeministri kroat na informoi që Kroacia ka vendosur financimin masiv të ndërtimit të korridorit nga ana e Kroacisë. Nga ana tjetër ne jemi në procesin e lidhjes së kontratave për pjesën kryesore të segmenteve të këtij korridori”.

Në muajin korrik Komisioni Europian pezulloi për Shqipërinë fondet për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural për shkak të praktikave të korrupsionit që ka gjetur në programin IPARD II, të zbatuar gjatë periudhës 2014-2020.



Ekipi i RisiAlbania, shprehet i lumtur të ndajë këtë përvojë dhe eksperiencë pozitive edhe në Bashkitë Berat, Elbasan dhe Lushnjë.

“Jemi gati të nisim ofrimin e shërbimeve të këshillimit të karrierës në komunitetet e tyre, sipas modelit të suksesshëm të Zyrës së Këshillimit të Karrierës - Bashkia Tiranë edhe në këto tri bashki”, njofton RisiAlbania.

Këshilluesit e karrierës në këto bashki dhe stafi i përkushtuar nga Qendrat Sociale të Bashkisë së Tiranës kanë nisur një rrugëtim transformues 10-ditor, në kuadër të trajnimit të organizuar nga RisiAlbania, i cili synon t'i fuqizojë ata në

erës për të rinjtë dhe të rriturit e interesuar.

Këshilluesit që punojnë në qendër janë trajnuar sipas standardeve ndërkombëtare profesionale dhe shkëmbimeve me homologët zvicernë. Zyra do të përdorë mjete bashkëkohore për të eksploruar fushat e karrierës me interes për punëkërkuarët, për të analizuar nevojat e tyre për këshillim dhe orientim, si edhe për të identifikuar vështirësitë që hasin të rinjtë e të rejtat dhe të rriturit në marrjen e vendimeve gjatë udhëtimit të tyre profesional.

Nga ana tjetër edhe autoritetet kanë ndërmarrë reforma në sistemin e AFP-së. Gjatë vi-

të jetë konstant, krahasuar me vitin e kaluar. Për vitin shkollor 2023-2024 në shkollat e arsimit profesional janë regjistruar rreth 14.500 nxënës. Për vitin mësimor 2023-2024, janë regjistruar në klasën e 10-të, rreth 4.270 nxënës. Numri i vajzave që ndjekin shkollat profesionale është rreth 2.250 nxënës. Rëndësi e veçantë në arsimin profesional i është kushtuar dhe gjithëpërfshirjes, ku politikat e AFP-së garantojnë mundësi të barabarta për të gjithë individët që duan të ndjekin studimet në AP. Kjo është e sanksionuar në ligjin e AFP-së, si dhe në Strategjinë Kombëtare të Punësimin dhe Aftësive 2023-2030.

# Dita Ndërkombëtare e Gruas Rurale, ministrja Denaj: Të shërbejë si thirrje për fuqizimin e saj

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj zhvilloi një takim me gratë ru-

duke ekspozuar produktet e tyre.

Gjatë bashkëbisedimit me

“Të gjitha këto janë pjesë e një dashurie dhe një pune të hollë që ka gruan nga pas. Dhe pavarësisht sa e vështirë është, ja ka dalë. Dua të vendos në fokus promovimin e gruas, jo vetëm si grua, por edhe si ministre e Bujqësisë. Në këtë fushë, besoj se forca e gruas është po aq e madhe sa e burrit. Madje, në disa raste e nënvlerësuar, sepse në sipërmarrje po të shikojmë statistikën vetëm 25 % janë të drejtuara nga gratë”, u shpreh ministrja Denaj, teksa vizitoi tryezat me produktet e tyre.

15 tetori shënohet Dita Botërore e Gruas Rurale, e cila synon njohjen e kontributit dhe rolit që gratë nga zonat rurale kanë në komunitet, duke përmirësuar jetën dhe mirëqenien në tërësi.

Dita Botërore e Gruas Rurale u caktua në vitin 1995 nga organizatat e shoqërisë civile në konferencën e katërt botërore për gratë në Pekin dhe u shpall ditë zyrtare në vitin 2007 nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së.



rurale dhe agropërpunuese, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas Rurale, për të diskutuar mbi sfidat dhe prioritetet e grave dhe vajzave në zonat rurale si dhe veprimet që duhet të ndërmerren për të përmirësuar mirëqenien e tyre, në veçanti rolin e grave në zinxhirët e vlerës në sektorin agro-ushqimor.

Ato u bashkuan në Tiranë

to, Denaj theksoi se kjo ditë duhet të shërbejë si një thirrje për të bashkëpunuar në rritje të produktivitetit, e për të kthyer traditën në zhvillim.

Sipas saj, fuqizimi i potencialit të gruas në komunitetet rurale dhe hapja e mundësive të reja me financime apo mbështetje, sjell një zhvillim të qëndrueshëm social ekonomik të tyre.

**Falë mbështetjes së projektit RisiAlbania, zyra e këshillimit dhe fushata e informimit kanë dhënë rezultate konkrete në rivitalizimin e arsimit profesional dhe rritjen e interesit tek të rinjtë e të rejtat që përfitojnë nga një vendimmarrje e mirëinformuar për karrierën, çka ka sjellë mirëqenien e tyre shoqërore e financiare.**

**Ekipi i RisiAlbania, shprehet i lumtur të ndajë këtë përvojë dhe eksperiencë pozitive edhe në Bashkitë Berat, Elbasan dhe Lushnjë.**

## MINISTRJA DENAJ TAKIM ME PËRFAQËSUES TË KASH-IT

## NË FOKUS TË TAKIMIT: PROCESI I KOOPERIMIT DHE KOORDINIMIT; FUSHA E MEKANIZIMIT, INOVACIONIT DHE DIGJITALIZIMIT; FUSHA E FINANCIMIT DHE DISBURSIMIT TË FONDEVE GRANT, SI DHE FUSHA E PËRMIRËSIMIT TË LEGJISLACIONIT DHE AKTEVE NËNLIGJORE

*Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj gjatë një bashkëbisedimi që zhvilloi në ambientet e MBZHR-së, me përfaqësues të KASH-it, vuri në dukje se, Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar është një partner i rëndësishëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në shumë procese konstruktive në detyrat e bujqësisë*

“Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH) është një partner i rëndësishëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) në shumë procese konstruktive në detyrat e bujqësisë.” Kështu u shpreh ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj gjatë një takimi që zhvilloi në ambientet e MBZHR-së, me përfaqësues të KASH-it, ku ndër tjera theksoi, që dëshiron ta intensifikojë këtë partneritet.

“Zhvilluam një takim të frytshëm me Këshillin e Agrobiznesit Shqiptar, një shembull model i bashkimit si fuqi e madhe për zhvillim, ku rreth 37 përfaqësues të sektorëve të ndryshëm të bujqësisë bashkëveprojnë në të mirë të gjithësecilit”, u shpreh Denaj.

Ministrja theksoi se, dëgjoi me vëmendje çështjet dhe nevojat e tyre, si një përgjegjësi e përbashkët për të rritur formalizimin dhe aksesin e fermerëve në tregje.

“Dakordësuam të standardizojmë komunikimin me pjesëmarrjen e 3 anëtarëve të KASH në grupet e punës për të përmirësuar operacionet gjatë vitit të ardhshëm, si edhe përfaqësues për këshillin e të urtëve”, deklaroi Denaj.

KASH përfshin në vetvete 25 shoqata kombëtare dhe 12 këshilla rajonale të agrobiznesit që operojnë në sektorët e bujqësisë, blegtorisë, peshkimit dhe akuakulturës, agrobiznesit, agropërpunimit, bimëve mjekësore e aromatike dhe bletarisë, agroturizmit, agropylltarisë dhe mjedisit në zonat rurale, tregjeve agrolektorale, financës dhe mikrofinancës.

**Çështja e parë** sensitive, që u diskutua dhe u dakordësua midis palëve ishte të punojnë e zgjidhin së bashku problemet që ndeshin gjatë Procesit të kooperimit dhe koordinimit. M.B.Z.H.R. në funksion të re-alizimit të objektivave të saj kooperon dhe koordinon veprimtarinë e subjekteve përfaqësuese të sektorit privat edhe me atë të subjekteve të tjera publike, që impaktojnë fushën e Ekonomisë së Ushqimit në Shqipëri. Gjithashtu edhe ato të vetë MBZHR me përfaqësues të subjekteve private dhe në veçanti me përfaqësues të subjekteve që operojnë në disa sektorë kryesorë në fushën e Ekonomisë ushqimit si atë të: Bujqësisë, Blegtorisë, Peshkimit dhe Akuakulturës, Agro-

biznesit dhe Tregjeve Agro-Blegtorale, Agropërpunimit, Bimëve Mjekësore-Aromatike & Agropylltarisë, Agroturizmit dhe Subjekteve të Ushqimit Social, Bletarisë, Bujqësisë Organike & Mjedisit në Zonat Rurale, si dhe Financës & Mikrofinancën.

KASH vlerëson se 354 mijë subjektet që kanë përfituar tokë sipas ligjit 7501 “Për tokën bujqësore” ushtrojnë veprimtarinë në sektorët e sipërcituar dhe në praktikë janë të grupuar tashmë në tre kategori:

Subjekte ose familje bujqësore të paformalizuara, që e përdorin tokën dhe asetet e tjera prodhuese, për të plotësuar vetëm nevojat familiare dhe të blegtorisë së tyre. Pjesën tjetër të tokës e lënë pa punuar dhe asetet e tjera prodhuese nuk po i përdorin me efikasitet.



Subjekte të paformalizuara që prodhojnë për të plotësuar nevojat e familjes, të blegtorisë së tyre, që u mbetet edhe një tepriçë prodhimi për treg, por kanë probleme për tregtimin e tyre. Disa nga këto subjekte e japin pjesën tjetër të tokës dhe asetëve me qera, me një marrëveshje verbale besimi, të pashoqëruar me një dokument ligjor.

Subjekte të formalizuara, të regjistruara në QKB apo në administratën tatimore, që përveç tokës dhe asetëve të tyre marrin edhe toka e asete të tjera me qera dhe punojnë për tregun e vendit dhe për eksport.

Procesi i kooperimit dhe koordinimit brenda secilit grupim dhe midis të tre grupeve të sipërcituara kërkon më shumë vlerësim, mbështetje dhe rikonceptim qëndrimi në radhë të parë nga MBZHR, mbasi është një proces shumë i vështirë, por që nuk kërkon shumë mjete financiare, për të arritur rezultate frytdhënëse për të gjithë. Gjithashtu është

provuar se procesi i kooperimit dhe koordinimit ka një ndikim mjaft dobiprurës, për të evidencuar vështirësitë e arritur në një konsensus, për të punuar së bashku në një front, që të zgjidhim problemet emergjente afatshkurtra, si dhe të evidencojmë e fusim në rrugën e zgjidhjes problemet afatmesme dhe afatgjata, duke vlerësuar me përparësi veçanërisht ato probleme që biem dakord se na preokupojnë dhe interesojnë të gjithëve.

MBZHR në kuadër të këtij procesi ka nisur punën si për krijimin e një Rrjeti rural dhe Dhomën bujqësore të tregtisë. Inisiativa është dobiprurëse dhe e mirëpritur nga ana jonë. Mënyra e zgjedhur për të arritur objektivin duke punuar vertikalisht pa kooperuar dhe koordinuar procesin në kohë

dhe hapësirë me përfaqësues të subjekteve që janë organizuar dhe punojnë prej shumë kohësh në sektorët e sipërcituar, kam bindjen se nuk do të na sjellë rezultatin që Ne po presim.

Problemi do të marrë zgjidhjen e duhur në rast se miratohet nga Ministrja një Program pune specifik, për zbatimin e të cilit të angazhohen institucionalisht dhe të punojnë në front, në të njëjtën kohë, si për krijimin e Rrjetit Rural dhe Dhomës së Bujqësisë dhe Ushqimit, përfaqësues nga subjektet e sektorit privat që punojnë në sektorët e sipërcituar, të MBZHR dhe strukturat e saj të varësisë, Institucionet shkencore dhe të arsimit profesional, të organeve të qeverisjes vendore, duke e mbështetur zbatimin e programit me logjistikë dhe financiarisht nga një ose disa donatorë.

Praktika e deritanishme në procesin e kooperimit dhe koordinimit ka provuar se iniciativat e ndërmarra veç e veç të pakoordinuara, si nga sek-

tori privat dhe ai publik dhe të zbatuara vertikalisht nga posht lart apo nga lart posht nuk ka dhënë asnjë rezultat pozitiv. Modelin dhe përvojën pozitive për hartimin dhe zbatimin e një Programi të tillë specifik Ne e kemi tashmë, Programin “Ulliri dhe Cilësia e vajit të ullirit në Shqipëri”, i cili po e përfundon me sukses fazën e parë të procesit të zbatimit dhe na rezulton një model e histori suksesi, që duhet e do të vijojë të zbatohet edhe në të ardhmen edhe për produkte të tjera, jo vetëm për bimën e ullirit dhe cilësisë së vajit të ullirit.

**Çështja e dytë sensitive ishte mbështetja dhe rivlerësimi që i duhet bërë veprimtarisë në:**

Fushën e Mekanizimit, Inovacionit dhe Digjitalizimit:

Shpopullimi i zonave rurale,



rritje e kostove në të gjithë sektorët e Ekonomisë Ushqimit, si pasojë e shumë faktorëve objektiv, por edhe ata subjektiv, detyrimet që lindin nga procesi i integritimit, etj., na detyrojnë që t'i kërkojmë zgjidhjet në përmirësimin e punës në këtë fushë. Mjetet financiare të fermerëve veçanërisht ata të grupit të parë dhe të dytë për blerjen e mjeteve të reja bujqësore janë të limituara. Rezerva qëndron tek rritja e koeficientit të përdorimit të mjeteve bujqësore dhe linjave ekzistuese të përpunimit të lëndëve të para agro-blegtorale. Gjithashtu në mbështetjen që u duhet dhënë mekanizatorëve për uljen e tarifës së shërbimeve me këto mjete. Koeficienti i përdorimit të mjeteve bujqësore, veçanërisht atyre që përdoren në vjeljen e prodhimit është ndjeshëm nën limitet, që ato të konsiderohen eficient sepse: Teknologjia e prodhimit të tyre është e vjetër. Përdorimi dhe mosha mesatare e pjesës më të madhe të traktorëve e

kombajnave i kalon 25 vite pune dhe sipas përlogaritjeve të amortizimit duhet të kishin dalë jashtë përdorimit. Parcelizimi i tejkajshëm i tokës rrit ndjeshëm kostot e punimeve të mekanizuara. Shumë mjete që janë në gjendje pune nuk kanë targa dhe janë me borxhe të palikujduara, që shumica e tyre na rezulton nga granti dhënë prej qeverisë së Japonisë por edhe nga donatorë të tjerë. Qendrat e Agroservisit për riparim të mjeteve bujqësore nga 54 që kanë qenë, janë reduktuar në 13. Çmimi i lartë i karburantit dhe programimi i subvencionit të limituar për naftën nën nevojat e domosdoshme, etj., etj., përbëjnë një emergjencë të domosdoshme ndërhyrjen në këtë fushë. Zgjidhja e problemit kërkon marrjen pa humbur më shumë kohë të një iniciative për

kualifikimi përdoruesve dhe koordinimi i punës midis këtyre tre subjekteve. Gjithashtu dhe mbështetja pa hezitim e çdo programi që parashikon përdorimin e tyre në zgjidhjen e problemeve emergjente dhe futjen në rrugën e zgjidhjes të problemeve afatmesme dhe afatgjata. Praktika e përdorimit të Platformës ABA Online në zbatimin e Programit Ulliri dhe cilësia e vajit të ullirit na provoi më së miri dobinë e madhe që ka përdorimi në masë të gjerë i digjitalizimit në praktikë, për të zgjidhur problemet emergjente dhe për të futur në rrugën e zgjidhjes problemet afatmesme dhe afatgjata.

**Çështja e tretë, por jo më pak sensitive se dy të parat ishte:**

Financimi & mikrofinanca, Programi IPARD, Paketa fiskale 2024, Skema kombëtare e mbështetjes dhe Buxheti MBZHR për 2024.

Programi IPARD si burimi kryesor i financimit ka aktualisht si prioritet marrjen e disa masave urgjente për menaxhimin e situatës, që na është krijuar mbas letrës së ardhur për ngrirje të procesit nga BE të disbursimit të fondeve IPARD II dhe IPARD III. Mirëdo të jetë që të ngrihet një grup pune i përbashkët ku të marrin pjesë edhe përfaqësues të sektorit privat që të punojë intensivisht, për të përgatitur takimin e Komitetit të Monitorimit të Programit IPARD III. Mobilizimi dhe angazhimi i të gjithë aktorëve të interesuar për zbatimin e Programit IPARD II dhe III është i domosdoshëm, për të reflektuar me urgjencë mbi masat e propozuara dhe çështjet që raporti BE ka evidencuar si mangësi në raportin final të auditimit. Gjithashtu edhe për të mundësuar miratimin e një dokumenti konsensual në komitet, për hapat që do të ndërmerren nga secili aktor, për vijimin normal të procesit të zbatimit të programit Ipar II dhe III. Momenti është tani që ekspertët të flasin pa hezitim për rezultatet pozitive të procesit të disbursimit. Gjithashtu për shkaqet e mangësive të konstatuara nga organet e kontrollit të BE lidhur me efikasitetin dhe transparencën e përdorimit të fondeve të Programit Ipar II dhe III. Në rast se nuk

## Denaj me ambasadorin Bucci: Instrumente të reja për rritjen e shkëmbimeve tregtare në Bujqësi

Shqipëria dhe Italia synojnë të thellojnë bashkëpunimin në fushën e bujqësisë përmes krijimit të instrumenteve të reja për rritjen e shkëmbimeve tregtare dhe përfitim të eksperiencës italiane në bujqësi dhe zhvillim rural.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj zhvilloi një takim me ambasadorin e Italisë në Shqipëri, Fabrizio Bucci, me të cilin diskutoi çështje të bashkëpunimit dypalësh në fushën e bujqësisë, peshkimit dhe zhvillimit rural.

Ministrja Denaj e cilësoi një takim të frytshëm diskutimin me ambasadorin e Italisë në Shqipëri, Fabrizio Bucci, ku fokus i veçantë iu kushtua zgjerimit të mëtejshëm të bashkëpunimit Shqipëri-Itali në sektorët e bujqësisë, peshkimit, përpunimit agrourban dhe në fushën e sigurisë ushqimore.

“Ndamë eksperiencat më të

mira në fushën e agroturizmit si dhe asistencës së qeverisë italiane në drejtim të përafrimit

drejtuar nga vizioni i përbashkët për krijimin e instrumenteve të reja për rritjen e shkëm-



të legjislativës me BE por edhe në procesin e anëtarësimit në tërësi”, u shpreh Denaj.

Ministrja Denaj tha se bashkë me ambasadorin Bucci vunë theksin në forcimin e marrëdhënies mes dy vendeve, drejt një faze të re bashkëpunimi të

bimeve tregtare dhe përfitim të eksperiencës italiane në bujqësi dhe zhvillim rural.

Italia është një partner strategjik i Shqipërisë në procesin e integritimit në Bashkimin Europian dhe bashkëpunimin ekonomik.

## Tajani: Përfshijmë Bujqësinë në investime, vijojmë importin e vajit shqiptar të ullirit

Zëvendëskryeministri dhe ministri i Jashtëm italian, Antonio Tajani, tha se, “Italia është e gatshme të bëjë gjithë e më shumë për rritjen e investi-

kët për shtyp, i kryeministri Edi Rama, në Romë, Tajani theksoi “Italia është e gatshme të bëjë gjithmonë e më shumë në rastin e një dreke pune që

të Fincantieri, por dhe Cassa Depositi e Prestiti”.

“Kemi shumë sektorë ku jemi të gatshëm të përforcojmë praninë tonë dhe të përforcojmë investimet tona duke u përfshirë në sektorin bujqësor ku sa i përket vajit dhe vullnetit për të vazhduar për të blerë produkte, vajin shqiptar”, deklaroi Tajani.

Gjithashtu vijoi Tajani, në sektorin e peshkimit mund të punojmë edhe më shumë me investime të tjera.

“Pra, gjërat po shkojnë në drejtimin e duhur dhe takimi i sotëm, dreka e punës që do kemi sot do të ketë si qëllim që të arrijmë këto objektiva”, u shpreh zëvendëskryeministri dhe ministri i Jashtëm italian, Antonio Tajani.



meve në Shqipëri”. Në konferencën e përbash-

miqtë tanë shqiptarë do të takojnë përfaqësuesit e industrisë

## Ministrja Denaj takim me përfaqësues të KASH: Do intensifikojmë partneritetin

(Vijon nga faja 3)

Skema kombëtare: Duhet programuar që vitin e ardhshëm të ketë një buxhet më të madh dhe të fillojë të aplikohet subvencionimi për njësi prodhimi sipas cilësisë fillimisht për ullirin dhe vajin e ullirit, si dhe në blegatori për qumështin dhe mishin.

Buxheti MBZHR për vitin 2024: KASH mbi bazën e vlerësimit të ekspertëve, bazuar në plotësimin e nevojave më minimale, që kanë sektorët privat të sipërcituar për t'u mbështetur nga MBZHR, për vitin 2024 do të duhen edhe rreth 70 milion euro shtesë mbi buxhetin që është parashikuar në program. Lobimi për ta mundësuar realizimin e këtij objekti duhet bërë nga të gjithë jo vetëm nga KASH.

**Çështja e katërt sensitive ishte**  
Përmirësimi legjislativ dhe akteve nënligjore,  
Dhe kjo është e lidhur me fillimin e punës pa humbur kohë, për hartimin e ligjit “Për sigurimin e pronës dhe prodhimin” në sektorët e sipërcituar. Amendimin e ligjit 38/2012 “Për shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor”. Amendimin e ligjit për Ullirin dhe cilësinë e vajit të ullirit dhe nxjerrjen e disa akteve nënligjore për konsolidimin e cilësisë. E cila është një fjalë kyçe që mundëson pa humbur shumë kohë zgjidhjen e shumë problemeve që nuk kanë gjetur zgjidhje deri tani.

KASH për çështjet sensitive

të trajtuara më sipër i ka bërë më parë MBZHR disa propozime konkrete dhe ka dhënë edhe alternativë për zgjidhje. Ka dërguar edhe një Memorandum bashkëpunimi, i cili ndihmon dhe lehtëson procesin për zgjidhjen e problemeve të trajtuara më sipër, por që nuk është konkretizuar akoma, pavarësisht nga negociatat e stërzgjatura midis palëve. Jemi në pritje të nënshkrimit të këtij dokumenti.

Dobiprurës për të gjithë rezultoi bashkëpunimi KASH me MBZHR për Programin “Ulliri dhe Cilësia e vajit të ullirit në Shqipëri” KASH ka dërguar për mendim Draft Programin për vijimin e punës në këtë sektor dhe është në pritje të një përgjigjeje.

Të gjithë Anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të KASH në takim me Ministrin Denaj diskutuan më në detaje edhe disa çështje të tjera sensitive që preokupojnë shoqatat anëtare të KASH. Ministrja i dëgjoi me

## Rama: Italia, investime në infrastrukturë, energji dhe bujqësi

Kryeministri Edi Rama deklaroi në Romë, në një konferencë të përbashkët shtypi me zëvendëskryeministrin dhe

rrugë financimit të vazhdimin të punimeve për Korridorin 8, punime të cilat ne i kemi nisur ndërkohë në një pjesë me fi-

gjerë panoramën e zhvillimit energjetik të Shqipërisë, e cila në përfundim të kësaj dekade do të jetë eksportuese neto e energjisë dhe të interesit të Italisë për të bërë pjesë e këtij zhvillimi”, tha Rama.

Kryeministri Rama nënvizoi faktin se eksporti i vajit të ullirit nga Shqipëria në Itali është rritur me 50 herë.

“Kemi prekur po ashtu edhe sektorin e ushqimit, duke sjellë për ju një fakt që vetëm me një nxitje të vitit të fundit nga ana e Ministrisë së Bujqësisë së Italisë dhe personalisht ministrit Lollobrigida, kemi arritur që të fillojmë zërbërjen e një potenciali të madh dhe shembulli i thjeshtë dhe kuptimplotë është se vetëm vitin e fundit, pra deri në gusht, eksporti i vajit të ullirit nga Shqipëria në Itali është rritur me 50 herë.

Italia është një prodhuese e ekselencës në vajin e ullirit, por është një importuese, mbetet një vend importues, vajit të ullirit dhe duke qenë se ne jemi në të njëjtin paralel me rajonin e Puglias dhe duke qenë se kemi një potencial të jashtëzakonshëm për një vaj ulliri shumë cilësor, atëherë nuk ka pse të mos jemi një destinacion shumë i preferuar i Italisë, gjë që ka nisur të materializohet”, theksoi Rama.



ministrin e Jashtëm italian, Antonio Tajani, se Italia pritet të investojë në infrastrukturë rrugore dhe hekurudhore, energji, bujqësi etj.

I pyetur për investimet strategjike të Italisë në Shqipëri Rama tha se, “janë investime në sektorë strategjikë, janë investime në infrastrukturë, ku Italia ka luajtur një rol vendimtar dhe ministri Tajani personalisht ka udhëhequr një proces të çlirimit të Korridorit 8 nga një bllokim shumë i gjatë dhe i pajustifikueshëm drejt përfshirjes së tij në rrjetin e korridoreve evropiane, gjë që i hap

nancimet tona, pastaj në fushën e sistemit hekurudhor ku Italia është përfshirë në ndërtimin e hekurudhës Tiranë-Durrës, por ku ka shumë ende për të bërë. Kemi folur dhe për linjën hekurudhore, jo vetëm të Korridorit 8, por dhe atë që lidh Durrësin me Prishtinën dhe Nishin dhe kështu me Evropën Qendrore”.

“Në fushën e energjisë pa diskutim ku kemi shumë nevoja e njëkohësisht objektiva të përbashkëta strategjike me Italinë dhe ku kemi prekur temën e interkonjeksionit mes Italisë dhe Shqipërisë dhe më

## Tajani: Linja veprimi në 3 fusha me Shqipërinë, infrastrukturë, energji dhe sektorin agrourban

Shqipëria dhe Italia angazhohen të rrisin më tej bashkëpunimin në tre sektorë, të infrastrukturës, bujqësisë dhe atë agrourban.

Në konferencën e përbashkët për shtyp me kryeministrin Edi Rama, në Romë pas takimit të Komitetit të Përbashkët për Investimet, Çështjet Ekonomike dhe Sociale, Shqipëri-Itali, zv/kryeministri dhe ministri i Jashtëm italian, Antonio Tajani theksoi nevojën e përfshirjes së sektorit privat në këtë bashkëpunim.

“Me Shqipërinë bashkëndajmë lidhje të forta historike. Komiteti i përbashkët ekonomik Itali-Shqipëri i

dha hov. Me miqtë shqiptarë, ramë dakord për disa linja veprimi në tri fusha të mëdha: Infrastrukturës, energjisë dhe sektori agrourban. Ne duam që të përfshijmë në këtë bashkëpunim të përforcuar strategjik edhe sektorin privat dhe ndërmarrjet kryesore si hekurudhat dhe kantieret e tjera, pra e shohim me shumë interes planin e zhvillimit që qeveria shqiptare ka vënë në kantier, ka filluar, edhe duam të kontribuojmë për rritjen e një vendi që ka me ne lidhje me të vërtetë të forta, antike, të vjetra”, u shpreh Tajani.

Ai vuri në dukje se në Itali ka komunitete shqiptare që je-

tojnë prej shekujsh.

“Janë qytetarë italianë që kanë ruajtur zakonet e tyre dhe atyre u janë shtuar shqiptarë kohët e fundit si tregues që ekziston kjo lidhje historike”, shtoi ai.

Tajani u ndal dhe te çështja e emigracionit.

“Për çështjen e emigracionit kemi një dëshirë të madhe për të bashkëpunuar. Së bashku folëm me Ministrin e Jashtëm gjatë mbledhjes së Ballkanit Perëndimor që Italia ka organizuar, sepse rruga e Ballkanit duhet mbajtur nën kontroll dhe nuk duhet të rritet prania e emigracionit klandestin. Pra bashkëpunimi i përkryer”, deklaroi Tajani.

interes përfaqësuesit e 37 shoqatave kombëtare dhe Këshillave Rajonale të Agrobiznesit, duke iu premtuar se bashkëbisedimi dhe bashkëpunimi me KASH dhe shoqatat anëtare do vijojë edhe në të ardhmen.

KASH i uroi sukses në detyrën e ministres dhe e garantoi se do të vijojë të jetë me MBZHR një oponent konstruktiv me synim mbarrëvajtjen e punës në të gjithë sektorët e Ekonomisë Ushqimit, si dhe një partner serioz në realizimin e objektivave të përbashkta.

AKTUALITET

# Denaj pret ambasadorin e Holandës: Theksuam nevojën për nisma të reja në dobi të bujqësisë

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj priti në një takim pune, bashkë me zëvendësministrin Enio Civici, ambasadorin e Mbretërisë së Holandës në vendin tonë, Reinouz Vos, ku u diskutua për bashkëpunimet e reja në fushën e bujqësisë.

Ministrja Denaj vlerësoi eksperiencën holandeze në fushën e blegtorisë dhe bujqësisë. “Theksuam nevojën për të çuar përpara vullnetin e mirë për bashkëpunim dhe mundësitë e jashtëzakonshme të bashkëpunimit mes dy vendeve tona”, tha Denaj.

Së bashku me ambasadorin Vos, vuri në dukje ministrja, “diskutua për bashkëpunime potenciale, në drejtim të mbështetjes të qendrave të bashkimit të blegtorëve dhe fermerëve në njësi

ekonomike”.

Denaj theksoi se, në fokus të interesit të përbashkët mes të dy vendeve tona është për të

së Holandës, është vlerë e shtuar për ekonominë tonë bujqësore”, u shpreh Denaj.

Kontributi i partnerëve tanë



përfituar ekonomikisht në vlerë dhe cilësi.

“Rritja e markës shqiptare, duke iu referuar eksperiencës

ndërkombëtarë, tha ajo, mbetet me rëndësi të veçantë për zhvillimin e bujqësisë sipas modelit dhe standardeve më të mira.

# Ministrja e Bujqësisë me ambasadorin Steiner: Rritje e prodhimeve shqiptare në tregun austriak

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj u takua me ambasadorin e Aus-

trisë në Shqipëri, Christian Steiner.

Denaj bëri të ditur se

gjatë takimit u diskutua mbi mundësitë për të rritur praninë e prodhimeve bujqësore “Made in Albania” në Austri.

“Diskutua mbi nevojën për të rritur praninë e prodhimeve bujqësore “Made in Albania” në Austri, në veçanti të perimeve, duke i promovuar e zgjeruar mundësitë e eksportit për kompanitë shqiptare”, tha Denaj.

Për sa i takon zhvillimit rural në zonat malore, ministrja Denaj i kërkoi ambasadorit më shumë bashkëpunim për të përfituar nga eksperiencia austriake për ngritjen e modeleve të suksesshme të bujtinave e agroturizimeve.



# Hidrovori i Karavastasë, Denaj: Garanton kullimin e 7 mijë ha tokë bujqësore në Divjakë e Lushnjë

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rral, Anila Denaj inspektoi punimet në hidrovori e Karavastasë, që do të garantojë kullimin e rreth 7 mijë hektarë tokë bujqësore në bashkitë Divjakë e Lushnje.

Hidrovori, një vepër e ndër-tuar në 1970, është nga më të rëndësishmit në Shqipëri dhe ndër të mëdhenjtë në Ballkan.

“Prej më shumë se dy vitesh po punohet në strukturën ndërtimore të tij dhe për zëvendësimin e 7 elektropompave ekzistuese, që do të mundësojnë largimin e ujërave, për çdo situatë të mundshme me reshje shiu. Kërkova zbatimin në kohë të kontratës dhe plotësimin e të gjithë kushteve teknike sipas standardeve”, de-

klaroi Denaj.

Rikonstrukcioni i tij dhe

përmbytjeve të tokës bujqësore në këto zona.



vendosja e pompave të reja elektro-mekanike japin siguri maksimale për evitimin e

Sipas ministres Denaj, ndërhyrja e këtij lloji është e para dhe kërkon një vëmendje të veçantë.

# Bashkëpunim Shqipëri-Izrael në fushën e bujqësisë

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj priti në një takim Galit Peleg,

u diskutua për disa çështje të rëndësishme për bujqësinë, me potencial për bashkëpunimin

njerëzore sipas praktikave më të mira të prodhimit në bujqësi.

“Do të vendosim në zbatim një program për trajnimin e ekspertëve të ministrisë, përmes agjencisë izraelite MASHAV (Agjencia për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar), që ka të bëjë me përcjelljen e njohurive për aplikimin e metodave novatore dhe teknologjive të larta në bujqësi”, theksoi ajo.

Denaj informoi se në takim u diskutua gjithashtu për forcimin e bashkëpunimit mes vendeve tona në të ardhmen, duke pasur në perspektivë nënshkrimin e marrëveshjeve ndërministrorë në fushën e bujqësisë.



ambasadore e Izraelit në Shqipëri.

Denaj informoi se në takim

Shqipëri-Izrael, siç është zhvillimi i teknologjisë, inovacioni dhe forcimi i kapaciteteve

# Denaj: Të integrojmë në bujqësi e blegtori teknologjinë e informacionit të përparuar

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj mori pjesë në ceremoninë hapëse të Konferencës Ndërkombëtare të Nanoteknologjisë, mes anëtarëve të Akademisë së Shkencave në Shqipëri, akademikëve dhe ekspertëve nga e gjithë bota.

“Me ndihmën e akademikëve duhet të integrojmë në bujqësi e blegtori teknologjinë e informacionit të përparuar me sistemet e investuara deri tani. Ndërtimi i kadastrave të ullirit dhe vreshtave, janë shembuj të suksesshëm të politikave tona për të identifikuar sipërfaqet e kultivuara”, u shpreh Denaj.

Denaj shprehu bindjen se përmes shfrytëzimit të të gjithë potencialeve teknologjike dhe bashkëpunimit me ekspertët, do të mund të sjellim një produkt bujqësor me kosto të

ulët e cilësi më të lartë.

Nga datat 16 deri 20 tetor 2023 po mbahet në Tiranë edicioni i parë i Konferencës Ndërkombëtare NanoBalkan

dhe Maqedonia e Veriut, me një gamë të gjerë kërkimesh aktuale në nanoshkencë dhe nanoteknologji, pas suksesit të dy eventeve të fundit



2023, me pjesëmarrjen e 40 ligjëruesve, ku 20 ligjërues janë nga Shqipëria, Kosova

të organizuara në Shqipëri, TNT2021 dhe TNT NanoBalkan2022.

## GRATË RURALE NË SIPËRMARRJE

# Gratë rurale kultivojnë ushqim cilësor për të gjithë

15 Tetori, është Dita Ndërkombëtare e Gruas në zonat rurale. Këshilli Agrobiznesit Shqiptar vjen me një mesazh sensibilizues për të gjithë shoqërinë, institucionet dhe aktorët e linjës, mbi rolin dhe kontributin e jashtëzakonshëm të grave dhe vajzave në zonat rurale të Shqipërisë.

Ky është një moment i rëndësishëm për të reflektuar mbi situatën sociale dhe ekonomike, sfidat dhe vështirësitë e jetës së përditshme të grave dhe vajzave për të siguruar mirëqenie të komuniteteve rurale, sipërmarrjeve dhe familjeve të tyre.

Në fokus të përpjekjeve tona mbeten mirëqenia dhe fuqizimi i grave dhe vajzave në zonat rurale, duke ndërgjegjësuar dhe krijuar një solidaritet mbarëshoqëror mbi kontributin e tyre të paçmuar në bujqësi e zhvillimin rural.

KASH si një organizatë në

mbështetje të komitetit rural, është në mbështetje të këtij sektori dhe lobon fort pranë dikasterit të Bujqësisë dhe projekteve të donatorëve për fuqizimin e Grave në Zonat Rurale në sipërmarrjet që ndërtojnë dhe kontributin që japin në cdo drejtim ku punojnë.

Zëri ynë pranë institucioneve, organizatave të ndryshme të shoqërisë civile, përfaqësuesve të vetqeverisjes vendore etj, është zë për

sfidat dhe prioritetet e grave dhe vajzave në zonat rurale si dhe veprimet që duhet të ndërmerren për të përmirësuar mirëqenien e tyre, në veçanti rolin e grave në zinxhirët e vlerës në sektorin agro-ushqimor.

Mbështetja ndaj Grave Rurale’ synon të nxisë krijimin e solidaritetit mbarëshoqëror për të fuqizuar gratë dhe vajzat në zonat rurale si dhe për barazi dhe drejtësi sociale.



## BUJQËSIA NË FOKUS

# Panairi "Agrotech Expo 2023", Civici: Mundësi bashkëpunimi në fushën e inovacionit në bujqësi

Zëvendësministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,

tikave të qeverisë shqiptare në mbështetje të fermerit dhe

konkurrueshmërisë në tregjet e eksportit", u shpreh Civici.

Fokusi i këtij panairi është të bëjë bashkë sipërmarrësit e agrobiznesit në Shqipëri me kompanitë e huaja nga vende si Kosova, Greqia, Spanja, Serbia, Holanda dhe Gjermania, të cilët janë të pranishëm në panair gjatë 3 ditëve.

Gjatë panairit pritet të zhvillohet dhe konferenca e vajt të ullirit, pasi është konstatuar potenciali i madh që ka ky sektor, për shkak të kërkesës së lartë. Kjo do të ndihmojë në rritjen e të ardhurave të fermerëve.

Ndërkohë tjetër faktor kryesor për zhvillimin e sek-



Enio Civici mori pjesë në ceremoninë e hapjes së Panairit Ndërkombëtar të Bujqësisë "Agrotech Expo 2023", që mbahet në Tiranë nga data 18 deri më 20 tetor.

Panairi ka bërë bashkë sipërmarrës që operojnë në sektorë të ndryshëm të bujqësisë dhe prezantojnë në këtë aktivitet një larmishmëri produktesh bujqësore, që nga ushqimi organik dhe agroturizmi, deri tek ambalazhimi dhe inovacioni në makineritë bujqësore.

Zv/ministri Civici vlerësoi cilësinë e produkteve që prezantohen në këtë panair si të njëjtë me atë të produkteve ndërkombëtare.

"Kjo vjen si sukses i poli-



përshirja e teknologjisë dhe inovacionit në sektor, faktorë të cilët kanë ndihmuar në rritjen e cilësisë së prodhimeve dhe

torit është edhe prezantimi i teknologjive të reja, përdorimi i të cilave sjellin efikasitet në prodhim.

## Panairi i vjeshtës, ekspozohen prodhimet bujqësore lokale të Dvoranit

Sezoni i vjeshtës shoqërohet edhe me shumë prodhime bujqësore vendase në treg, për të cilat fermerët kanë punuar gjatë gjithë sezonit të verës.

Në fshatin Dvoran në Korçë, fermerë dhe agrobiznesmenë u bënë pjesë e Panairit të Vjeshtës, duke ekspozuar larminë e prodhimeve tipike të zonës, nga molla, rushi, zahiretë e dimrit, kompostot e shumë të tjera.

Fermerët shprehen se këtë vit sezoni ka qenë i mbarë për një pjesë të mirë kulturave, teksa synojnë të zgjerojnë tregjet e shitjes.

Në Panairin e Dvoranit në

Korçë spikati ekspozimi i varieteteve të ndryshme të mollës që kultivohen aty, si një nga kulturat kryesore që prodhohet bollshëm në rajonin juglindor.

Kryetari i bashkisë Korçë, Sotiraj Filo, publikoi në rrjetet sociale foto nga aktiviteti i organizuar, teksa tha se, "festa e Vjeshtës edhe këtë vit në fshatin Dvoran ka për qëllim promovimin e një prej produkteve tona më të njohura".

Panairi u shoqërua nga një program i pasur artistik me lojërë për fëmijë, muzikë dhe aktivitete plot argëtim për pjesëmarrësit e shumtë.

Molla e Korçës mbetet e pakonkurrueshme në cilësi e shije, ndaj dhe fermerët prodhues të këtij fruti synojnë zgjerimin e tregjeve të shitjes.

Fermerët e rajonit të Korçës prodhojnë rreth 100 mijë tonë mollë në vit dhe mbi 40 % e këtij prodhimi ruhet në kushte frigoriferike.

Eventi bëri bashkë vizitorë e familjarë të cilët bashkërisht ndihmuar fermerët në vjeljen e mollëve. Festa vijoi deri në orët e vona të mbrëmjes nën tingujt e muzikës, kërcimit dhe degustimit të ushqimeve tradicionale të zonës.

## Skema Kombëtare, AZHBR subvencionon 1219 fermerë për inputet bujqësore

Në Skemën Kombëtare të Mbështetjes në Bujqësi 2023, në kuadër të masës për fara, fidanë dhe inpute të tjera janë subvencionuar 1219 fermerë në të gjithë vendin, për një sipër-

faqe të mbjellë prej 881 ha.

Këtë vit është rritur me 56 % sipërfaqja e kultivimit mbështetur në krahasim me vitin e shkuar.

Në sajë të kësaj mase parashi-kohet financim për kultivimin e

perimeve, rrushit për tavolinë në serra dhe/ose luleshtrydheve në tunele plastike për fermerët individual ose grupet e fermerëve, me sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 ha.



## Lehtësim procedurash për 754 shërbime ndaj bizneseve - Ministrja Delina Ibrahimaj: Do të fillohet me sektorin e turizmit

Janë gati 754 shërbime që ofrohen ndaj bizneseve të cilat do të lehtësohen, jo vetëm në aspektin e dokumentacionit por edhe të afateve. E ftuar në emisionin "Scan Live", Ministria e Sipërmarrjes dhe Klimës së Biznesit Delina Ibrahimaj tha se do të fillohet me sektorin e turizmit.

De-rregullimi tha ministrja nuk është një proces që fillon dhe mbaron por edhe një proces i vazhdueshëm. Paralelisht tha Ibrahimaj do të krijojmë një mekanizëm të mos ngrihen më barriera administrative, ndërsa la të hapur mundësinë edhe për rishikimin e tarifave.

Me tej ministrja u ndal edhe tek censi të cilin e konsideroi

me rëndësi për orientimin e politikave.

ministrja do të shërbejë edhe për sektorin bujqësor duke



Të dhënat që do të gjenërohen prej censit shtoi më tej

diktuar vendimmarrjen e Ministrisë së Bujqësisë.

## Ekonomi për ATSH-në: Censi i popullsisë dhe banesave, bazë për regjistrimin e ardhshëm të bujqësisë

kanë të bëjnë me pronën, siç është banesa, me pronën siç është toka dhe kulturat drufrutore. Ky proces bën të mundur që të krijohet një listë paraprake e të gjitha këtyre familjeve, ose njësive ekonomike familjare, të cilat duhet të jenë potencial për të zhvilluar regjistrimin e ardhshëm të bujqësisë dhe të blegtorisë në vend".

"Censi i popullsisë dhe banesave krijon mundësinë për të

bërë një punë paraprake, për të krijuar një listë për regjistrimin e ardhshëm të bujqësisë dhe blegtorisë në vendin tonë", theksoi Ekonomi.

Ekonomi vuri në dukje rëndësinë dhe domosdoshmërinë e regjistrimit të bujqësisë në vendin tonë.

"Në vendin tonë është i domosdoshëm regjistrimi i Bujqësisë, kjo për faktin se bujqësia jo vetëm është një nga sektorët më të rëndë-

sishëm të ekonomisë kombëtare, por dhe regjistrat ku bazohet prodhimi bujqësor që kanë nevojë për një përditësim 10-vjeçar. Censi i Bujqësisë, luan rol vendimtar në përditësimin e informacionit statistikor të nevojshëm në nivel lokal dhe kombëtar dhe pasqyron ndryshimet që kanë ndodhur në këtë sektor, në më shumë se një dekadë", u shpreh Ekonomi.

"Kështu, regjistrimi i bujqësisë dhe blegtorisë është në

fokus të punës, të planit 5-vjeçar të INSTAT dhe regjistrimi i bujqësisë dhe blegtorisë në Shqipëri do të nisë në 2024. Censi do të kontribuojë gjithashtu në krijimin e regjistrat statistikor të fermave, i cili do të jetë burimi i vrojtimeve me karakter bujqësor në të ardhmen. Aktualisht, INSTAT ka filluar fazën parapërgatitore për realizimin e këtij ushtrimi", tha Ekonomi.

"Fillimisht është përgatitur

një modul pyetjesh të cilat janë përfshirë në pyetësorin e censit të popullsisë dhe banesave me qëllim krijimin e listës së fermave bujqësore, e cila do shërbejë kornizë për censin e ardhshëm të njësive ekonomike bujqësore, kjo për arsye të mungesës së regjistrat administrativ të fermave", informoi Ekonomi.

INSTAT parashikon të mbledhë edhe module të veçanta në të gjithë fermat bujqësore që kanë të bëjnë me ujitjen, praktikën e menaxhimit të tokës, makineritë, pajisjet dhe pemëtarinë.

## NDRYSHIMET KLIMATIKE

## Denaj: Sigurimi në bujqësi, i rëndësishëm në kushtet e ndryshimeve klimatike

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj mori pjesë në konferencën ndërkombëtare të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) "Zhvillimi i Sektorit të Sigurimeve – Mundësitë dhe Sfidat në Evropën Juglindore".

Denaj tha se, sigurimi në bujqësi mbetet një çështje e rëndësishme, në kushtet ndryshimeve klimatike, që e vënë drejtpërdrejt në rrezik prodhimin bujqësor dhe aktorët e zinxhirit të vlerës së bujqësisë.

"Kërcënimi nga ndryshimi klimatik, siç është thatësira, reshjet, breshëri etj., është një kërcënim që po ndodh në të gjithë globin dhe Shqipëria nuk bën përjashtime dhe pavarësisht sesa i zhvilluar apo pak i zhvilluar, apo i pazhvilluar të jetë një sektor në një vend. Ky kërcënim është një kërcënim real, që sigurisht skemat e sigurimit, janë ndihmë absolute për të zhvilluar në mënyrë më të mirë dhe me një risk më të ulët", u shpreh Denaj.

Denaj u shpreh për një gërshetim të skemave të sigurimit

me masat që merr qeveria për nxitjen e sigurimit në bujqësi.

"Në këtë aspekt gërshetimi jo vetëm i skemave të sigurimit, por edhe i disa masave që merren paraprakisht nga qeveria, me ligjet përkatëse, por edhe me skemat e mbështetjes ekonomike financiare, i paraprijmë disa nga investimeve që janë të domosdoshme, që ky risk të mitigohet dhe kompanitë e sigurimit të kenë interes për t'u futur në këtë treg, sepse është një treg i hapur, ku interesi duhet të ekzistojë nga kompanitë, por dhe risku të jetë i moderuar", tha ministrja.

Në adresim të kësaj çështjeje, Denaj shprehu falënderim të veçantë për të gjithë skemat mbështetëse të programit IPARD II, që siç tha ajo, "janë skemat që e kanë shoqëruar përgjatë viteve të shkuara zhvillimin e ekonomisë bujqë-

sore, në atë që është jo vetëm shkallë, por edhe në investimet e duhura duke filluar nga serrat dhe jo vetëm".



Nga ana tjetër, vijoi ajo, "mendoj se projeksionet për të ardhmen, për IPARD III për të gjithë vendet e rajonit, janë një burim shumë i mirë investimi,

për të mitiguar këto risqe dhe për ta bërë sektorin e sigurimit atraktiv dhe në sektorin e bujqësisë".

se bashkimi i fermerëve do të rrisë aksesin në financim dhe ekonominë e shkallës.

Ministria ftoi kompanitë e sigurimit të ndërmarrin më shumë risk mbi supë dhe të shikojnë se si mund ta ndajnë këtë me fermerët.

"Kemi fermerë nga ata që nuk janë vetëm me 1 ha, por kemi fermerë që kanë shembuj shumë të mirë, falë IPARD-it dhe në sipërfaqe toke, pra ky është qëllimi i konferencës dhe diskutimi në panel për ta sjellë këtë diskutim në këtë lloj niveli, për shkëmbim pikëpamjesh dhe shprejoj që së bashku, qeveria, industria dhe palët e përfshira në industri, pra kjo është rrugëzgjdhje sesi të shkojmë më tej", u shpreh Denaj, teksa vuri theksin në rritjen e edukimit financiar për sektorin rural si një faktor i rëndësishëm që do të rrisë ak-

Gjithashtu theksoi Denaj, skemat kombëtare që për të disatin vit rresht shkojnë për fermerin e vogël janë një mbështetje, teksa vuri në dukje

## Raporti i Bankës Botërore, bujqësia një nga sektorët më të prekur nga ndryshimet klimaterike

Sipas raportit, rajoni duhet jo vetëm të adresojë barrierat ndaj pjesëmarrjes më të madhe në forcën e punës, por edhe të përshpejtojë konvergencën ekonomike me ekonominë më të përparuar të Europës. Këto përpjekje duhet të shoqërohen me tranzicion më të shpejtë drejt ekonomisë së gjelbër dhe më shumë investime për të rritur qëndrueshmërinë ndaj fatkeqësive natyrore, ndër të tjera edhe në bujqësi.

"Bujqësia është një nga sektorët më të prekur nga thatësirat, shkurtimi i stinëve dhe kushtet e paparashikueshme të motit. Rritja e mbrojtjes së bujqësisë nga rreziqet natyrore

dhe përpjekjet për ta bërë atë sa më të qëndrueshme do i lejojë ekonominë e Ballkanit Perëndimor që të jenë në gjendje të vazhdojnë të rrisin produktivitetin bujqësor kundrejt ndryshimeve të pafavorshme klimatike dhe të prodhojnë në mënyrë të qëndrueshme më shumë ushqime cilësore për konsum të brendshëm, por edhe për eksport, edhe drejt BE-së", tha Natasha Rovo, Ekonomiste e Lartë e Bankës Botërore dhe një nga autorët kryesorë të raportit. "Kjo kërkon përmirësim të politikave publike dhe investimeve për të nxitur përdorimin e gjerë të teknologjive dhe praktikave inteligjente për klimën

nga fermerët të mbështetur nga institucione më të forta publike, të cilat janë thelbësore për rritjen e qëndrueshme bujqësore."

Ndërkohë që sektori i bujqësisë në rajon po tkurret, ai vijon të mbetet shumë i rëndësishëm, për shembull nëpërmjet punësimit në këtë sektor nga shtatë deri në 35 përqind të popullsisë në gjashtë vendet e rajonit. Sipas raportit, bujqësia e gjelbër ofron një mundësi për rritjen e produktivitetit, konkurrencës dhe qëndrueshmërisë së sektorit, përmes përdorimit efikas të fondeve publike në dispozicion, njohurive dhe inovacionit.

## Breshëri dëmton kulturat bujqësore në Maliq, ekspertët e Bujqësisë në terren, për vlerësimin e situatës

Zëvendësministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Arian Jaupllari, tha se "pro-

javën që shkoi. Jaupllari tha se, "sot, përballimi i ndryshimeve klima-



gramet e qeverisë mbështesin investimet e fermerëve, për uljen e dëmtimeve në bujqësi nga ndryshimet klimaterike".

Zv/ministri Jaupllari bashkë me prefektin e Korçës, Nertil Jole, kryetarët e bashkive Maliq e Devoll, Gëzim Topçiu dhe Eduard Duro, zhvilluan në fshatin Zëmblak, Maliq, një takim me rreth 40 fermerë, pemëtoreset e të cilëve u dëmtuan nga breshëri i rënë

tike me ndikim në prodhimin bujqësor, mbetet një sfidë e rëndësishme".

"Dëmet e shkaktuara nga kushtet e motit në tokat bujqësore, kryesisht në pemët e mollëve në qarkun e Korçës janë në vëmendjen e strukturave të Ministrisë së Bujqësisë, duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm me fermerët e prekur", u shpreh Jaupllari.

sesin në financim.

"Prej 2016 kemi një skemë të garancë sovranë që e zhvillojmë së bashku me BERZH dhe besoj se këtu bankat mund të bëjnë diçka më të madhe për të ndihmuar në edukimin financiar", tha ajo.

Denaj nënvizoi se sistemi i sigurimeve lejon që bujqësia të bëhet më e efektshme.

"Së bashku me Bankën Botërore po ndërtojmë një projekt të përbashkët i cili mishëron pikërisht këtë qasje inkluzive dhe kombinon disa instrumente financiare njëherësh për të rritur efikasitetin e tyre", u shpreh ministrja.

"Zhvillimi i sigurimeve në bujqësi mbetet një prioritet për ne, por ai duhet të jetë pjesë e një plani më të gjerë të afrimit të sektorit financiar me bujqësinë që duhet të kalojë nga rritja e besimit të ndërsjellë të aktorëve, përmes dijës, rritjes së ekspozimit të bujqësisë me produktet financiare dhe sigurimeve", deklaroi ministrja Denaj.

## Spanja goditet rëndë nga rritja e çmimit të vajit të ullirit - Çfarë impakti do të ketë kjo në Europë?!

Thatësira dhe valët ekstreme të të nxehtit kanë përgjysmuar prodhimin spanjoll të vajit të ullirit. Çmimi në origjinë është rritur me 112 % që nga viti i kaluar.

Vaji i ullirit është një nga produktet më të konsumuara në botë dhe një përbërës thelbësor i dietës mesdhetare. Por muajt e fundit kanë parë që çmimi i tij ka arritur nivele të larta historike. Askund në Bashkimin European nuk është goditur më shumë se Spanja, pavarësisht se është prodhuesi kryesor në botë i produkteve thelbësore për dyqanet dhe marketet.

Thatësira dhe valët ekstreme të të nxehtit kanë përgjysmuar prodhimin spanjoll të vajit të ullirit. Çmimi në origjinë është rritur me 112 % që nga viti i kaluar,

Një litër vaj në dyqanet spanjolle është rritur me 52.5 % në një vit, shumë mbi mesataren europiane prej 38.3 % dhe

të vendeve të tjera prodhuese si Italia, Greqia dhe Portugalia.

Rritja e kostonë së vajit të ullirit po rrit edhe çmimin e produkteve të tjera, duke përfshirë edhe mallrat e konservuara. Tani në Spanjë, përbërësi më i shtrenjtë në një kanaçe sardele është vaji i ullirit që përmban.

Spanja eksporton 70 % të



prodhimin të saj të vajit të ullirit, që do të thotë se konsumatorët spanjollë tani duhet të konkurrojnë për këtë mall në një treg global gjithnjë e më konkurrues.

"Në Spanjë, ne jemi mësuar që çmimet e vajit të ullirit të jenë më të ulëta se pjesa tjetër e botës," thotë Jaime Lillo, zëvendësdirjtor në Këshillin Ndërkombëtar të Ullirit. Dhe kështu ajo që ka ndodhur është se në Spanjë, ku çmimet ishin më të ulëta, ata kanë lëvizur më shumë në përputhje me çmimet italiane, me çmime të paguara në Shtetet e Bashkuara, në Francë, në Greqi.

Prodhimi i këtij viti pritet të jetë i ngjashëm me atë të vitit të kaluar. Një ulje e mundshme e çmimit të vajit të ullirit do të vijë vetëm me një rritje të prodhimit dhe një lehtësim nga moti ekstrem që vendet mesdhetare i janë nënshtruar gjithnjë e më shumë së fundmi.

Ai bëri të ditur se, përmes Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (AREB), Korçë, specialistët e MB-ZHR-së janë gjendur në terren, për të parë dëmet dhe për të përgatitur informacionin e plotë mbi situatën, me qëllim vlerësimin e trajtimit e mëtejshëm të situatës.

Jaupllari u shpreh se, disa nga mjetet parandaluese të dëmeve janë rrjetat antibreshër, të ndërtuara tashmë në disa ferma të qarkut me financim nga programet e qeverisë shqiptare.

"Ky mekanizëm i suksesshëm ka eliminuar dëmet nga kushtet klimatike dhe ne synojmë ta zgjerojmë numrin e fermave që aplikojnë këto metoda", deklaroi zv/ministri i Bujqësisë.

Përdorimi i rrjetave antibreshër i lejon fermerët që të mbajnë një furnizim të vazhdueshëm në treg, duke ulur rrezikun e humbjes së prodhimit, siguron rritjen e cilësisë, minimizimin e dëmit, uljen e shpenzimeve agroteknike, etj.

## OBSH: Ndryshimi klimatik nuk është një kërcënim i largët

Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), Tedros Adhanom Ghebreyesus, theksoi se ndryshimi klimatik nuk është një kërcënim i largët dhe se ai ndikon jetët dhe ekosistemet.

Ghebreyesus bëri një vlerësim lidhur me ndryshimin e klimës përmes një postimi nga platforma e medias sociale X, njohur më parë si Twitter.

"Ndryshimi klimatik nuk është një kërcënim i largët. Aktualisht po realizohet, po ndikon jetët dhe ekosistemet. Të mblidhemi, të reduktojmë emetimet, të mbështesim qëndrueshmërinë dhe të krijojmë një rrugë të vazhdueshme", deklaroi Ghebreyesus.

Kreu i OBSH-së ka tërhequr vëmendjen se përveç përmbajtjeve dhe zjarreve shkatërruese në të gjithë

botën po përjetohen valë e motit të nxehtë dhe thatësira afatgjata.

Ghebreyesus theksoi se e ardhmja e botës dhe e brezave të rinj varet nga këto hapa që do të hidhen në çështjen e klimës.

Kohët e fundit në të gjithë botën po përjetohen ngjarje ekstreme natyrore, ku korriku 2023 është regjistruar si muaji më nxehtë deri më tani.



### SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

### KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

[www.kashalbania.org](http://www.kashalbania.org)

# Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar





# KREDI E SHPEJTË MIKRO PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

**KREDI MIKRO**

deri në **2,500,000** LEKË



**FED**  
invest 

**GJITHMONË  
FINANCË SOCIALE**

## AGROTURIZËM

## Ministrja Denaj takim me Shoqatën e Agroturizmit, nxitje për certifikimin e njësive

Zhvillimi i agroturizmit në zonat rurale përmes zbatimit të modeleve unike dhe të qëndrueshme të biznesit, bazuar në vlerat natyrore, kulturore dhe tradicionale, duke u diversifikuar nga aktivitetet tradicionale të bujqësisë, është një nga sfidat e qeverisë.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj u takua sot me përfaqësues të Shoqatës së Agroturizmit, ku në vëmendje ishte edhe certifikimi i njësive agroturistike.

“Me Blerinën dhe Shpresimin, nga Shoqata e Agroturizmit folëm për rëndësinë e

këtij sektori si një model që përfshin të gjithë zinxhirin i vlerës, nga ferma në tavolinë. Shprehja gatishmërinë për të zgjeruar më tej bashkëpunimin me shoqatën, duke iu ardhur në ndihmë me nxitjen e certifikimit të njësive agroturistike”, u shpreh Denaj.

Sipas ministres, ushqimi është pjesë thelbësore e ofertës turistike shqiptare. “Së bashku do të punojmë drejt rritjes së cilësisë së prodhimeve shqiptare dhe promovimit të tyre përmes aktiviteteve lokale e ndërkombëtare”, tha Denaj.

Potenciali turistik i zonave

rurale krijon mundësi shumë të mira për ngritjen e sipërmarrjeve agroturistike, të cilat janë shndërruar në destinacionin e preferuar për turistët vendas e të huaj, në çdo stinë të vitit.

Investimet për sektorin e agroturizmit kanë pasur një interes përtej pritshmërive të parashikuara, ndaj ky sektor do të ketë vëmendje të shtuar në programet në vijim nga qeveria, u shpreh ministrja Denaj, teksa vuri në dukje se, “sot agroturizmet, që janë shtrirë kudo në zonat rurale dhe jo vetëm, janë pasuri të mëdha, që po kthehen në të ardhura të larta për njerëzit e fshatit.

## Strategjitë për të ndërtuar një biznes të qëndrueshëm - RisiAlbania njofton për organizimin e nje serie webinaresh

Projekti RisiAlbania e ka shtrirë mbështetjen e saj dhe në sektorin e Agroturizmit

Zhvillimi i agroturizmit në zonat rurale përmes zbatimit të modeleve unike dhe të qëndrueshme të biznesit, bazuar në vlerat natyrore, kulturore dhe tradicionale, duke u diversifikuar nga aktivitetet tradicionale të bujqësisë, është një nga sfidat e qeverisë e cila po bashkëpunohet me donatorët në këtë drejtim.

Produktet autoktone në agroturizëm, janë një faktor kyc në rrugën drejt ndërtimit të një sistemi ushqimor të qëndrueshëm në Shqipëri.

Pikërisht në këtë drejtim por edhe në aspektin e elaburimit të faktorëve të tjerë të suksesit

drejt turizmit të qëndrueshëm, janë disa nga dretimet ku është fokusuar puna e projektit Risi Albania me aktorët e këtij sektori.

“ A jeni gati të ndryshoni qasjen e biznesit tuaj ndaj turizmit të qëndrueshëm? A dëshironi të zbuloni faktorët e suksesit drejt turizmit të qëndrueshëm? Nëse jeni të gatshëm të merrni pjesë në një aventurë të re që do të transformojë mënyrën si operoni, ky njoftim është për ju!

Bashkohuni me ne në serinë e webinarëve mbi turizmin e qëndrueshëm, ku ekspertët ndajnë praktikën më të mira dhe strategjitë për të ndërtuar një biznes të qëndrueshëm dhe të suksesshëm, duke rritur ak-

sesin në tregje me vlerë të lartë dhe respektuar komunitetet lokale.

Kjo seri webinaresh organizohet në bashkëpunim me HSLU Hochschule Luzern (HSLU), përgjatë muajve Tetor-Dhjetor 2023. Në linkun e regjistrimit do të gjeni temat dhe datat e sakta për secilin webinar.

Regjistrohuni në: <https://forms.office.com/e/HK46-du7nMk>

Në përfundim të webinarëve do të pajiseni me certificate pjesëmarrjeje.

Së bashku, mund të ndërtojme një të ardhme më të qëndrueshme dhe të pasur për turizmin në Shqipëri !” thekson në njoftimin e saj RisiAlbania.

## “Ardenica” në Lushnjë, tjetër bujtinë e mbështetur nga AZHBR

Në kodrat e Ardenicës në Lushnjë, mes atraksioneve të kësaj zone, ndodhet bujtina “Ardenica”, një tjetër sipërmarrje e suksesshme, e mbështetur nga Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, (AZHBR) përmes programit IPARD II.

Nisur si një një biznes i vogël familjar, “Ardenica” është shndërruar në destinacionin e preferuar të shumë turistëve, të cilët tërhiqen nga bukuritë natyrore, vlerat kulturore dhe historike të kësaj zone. Falë mbështetjes, sipërmarrësit përmirësuan dhe zgjeruan kapacitetet pritëse dhe akomoduese për vizitorët, si edhe rritën bashkëpunimin me fermerët për sigurimin e ushqimit të freskët nga ferma në tavolinë.

Zhvillimi i turizmit rural është një ndër objektivat e programit IPARD II për të rritur aktivitetin ekonomik në fshatra, duke dhënë impakt të drejtpërdrejtë në rritje të punësimit

dhe zhvillimin e ekonomisë familjare rurale.

AZHBR bëri të ditur se,

për ndikimin në ekonominë lokale.

Si kombinim perfekt mes



vitin e fundit ka një interes të shtuar nga banorët e zonave rurale, të rinj kryesisht, por jo vetëm, për të bërë investime të tilla. Në shumë raste, modelet e agroturizmeve po konkurrojnë fort, duke e shndërruar këtë sektor nga më të rëndësishmit në vend

turizmit dhe bujqësisë, strategjia e agroturizmit ka rezultuar e suksesshme, duke garantuar treg të sigurt për fermerët e zonave rurale, rritjen e ekonomisë për familjet e angazhuara në punët e brendshme, apo të zinxhirit të furnizimit në këto njësi.

## “Verë dhe gështenja”, Rama: Panair produktesh e plot surpriza të tjera në Pogradec

Festa “Verë dhe gështenja”, e kthyer tashmë në traditë në qytetin e Pogradecit, do të mbledhë këtë fundjavë vizitorë të shumtë, të cilët do të shijojnë produktet vendase.

Kryeministri Edi Rama ndau në rrjetet sociale videon promovuese të këtij aktiviteti, që ka në fokus promovimin e produkteve tradicionale vendase.

“Verë dhe Gështenja, nesër

dhe pasnesër në Pogradec në sheshin kryesor të qytetit. Festojmë bashkë me verë buti, gështenja të pjekura, muzikë moderne dhe popullore, panair produktesh e plot surpriza të tjera”, tha Rama.

Edhe këtë vit nuk do të mungojnë tezgat në shërbim të të gjithë të interesuarve që dëshirojnë të tregtojnë verën e tyre apo produkte ushqimore tradicionale.

Po ashtu, bizneseve u rikohet mundësia që të promovojnë gatimet e tyre tradicionale, punimet artizanale si dhe të vendosin kontakte për shitjen e prodhimeve të zonës në tregje të reja.

Prodhimi i verës mbetet një traditë për qytetin e Pogradecit, ndërsa verërat pogradecare në vite, kanë marrë edhe disa çmime ndërkombëtare.

## Bujtina “Lëpushë”, atraksion agroturistik në Alpet Shqiptare

Janë disa fshatra në komunën Kelmend në Malësinë e Madhe në qarkun e Shkodrës, që me ndërtimin e rrugës së re dhe ngritjen e bujtinave, pikave agroturistike, kanë filluar të vizitohen në masë nga turistët e huaj dhe ata vendas.

Për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, diversifikimi i fermës është një nga perspektivat më kuptimplote ekonomike për fshatin shqiptar, që po mbështetet dhe nxitet nga qeveria, si alternativa më e mirë për zhvillimin e ekonomisë lokale, në kushtet edhe të sipërfaqeve të tokës mesatarisht të vogla.

Bujtina e Paulin Nilajt në Lëpushë, midis Alpeve Shqiptare, cilësohet nga shumë turistë të huaj dhe vendas si një nga destinacionet më të kërkuara shplohëse dhe me një kulinari fanstastike.

“Bujtina Lëpushë” vitet e fundit është përballur me një fluks gjithmonë e në rritje të vizitorëve. Me ndihmën dhe nën asistencën e ekspertëve të bujqësisë dhe programit CoSolve që zbatohet nga GIZ Albania dhe MBZHR, Paulini mundi të rriste kapacitetin e kuzhinës së bujtinës dhe në të njëjtën kohë rrjedhimisht hapjen e vendeve të reja të punës.

Bjeshkët e Lëpushës dallojnë për bukuritë e veçanta natyrore. Me mbështetjen e AZHBR-së banorët e zonës po kthejnë shtëpitë e tyre në bujtina pritëse që mundësojnë strehimin e turistëve të ndryshëm dhe nxisin zhvillimin e agroturizmit në këtë zonë.

Janë mbi 144 investime në sektorin e agroturizmit, që janë mbështetur me grante nga programi IPARD II. Investimet për sektorin e agroturizmit kanë pasur një interes përtej pritshmërive të parashikuara, ndaj ky sektor do të ketë vëmendje të shtuar në politikën mbështetëse të qeverisë.

Investimet në agroturizëm përfitojnë 50 % financim. Mbështetja me grante e një investimi ka impakt në formalizimin

e sektorit dhe zhvillimin e tij.

Agroturizmi është kthyer në një motor zhvillimi ekonomik për zona shumë të thella bujqëtare dhe blegtorale dhe politikantë nxitëse dhe incentivuese janë të orientuara sipas kërkesës dhe nevojës së sipërmarrësve ruralë. Të dy programet që ka implementuar qeveria, IPARD dhe Programi i Mbështetjes në Bujqësi që prej vitit të kaluar, mbështesin me financime diversifikimin e ekonomisë së zonave rurale.

Masa 7 e programit IPARD ka pasur si objektivi mbështetjen e investimeve në zonat rurale, me qëllim diversifikimin e ekonomisë rurale dhe krijimin e bizneseve që sjellin mundësi punësimi dhe përfshirje sociale.



EXCITING NEWS!

Get ready for a deep dive into eco-friendly travel practices.

Sustainable Tourism

# Webinar

series

#sustainabletourism  
#webinarseries

With the contribution of:

Lucerne University of Applied Sciences and Arts  
**HOCHSCHULE LUZERN**



## Muqostepa: E rëndësishme të hiqen barrierat në biznes me Bashkimin Evropian

Ines Muqostepa, presidente e Unionit të Dhomave të Tregtisë në Shqipëri, tha se, "ecuria e biznesit rajonal i

pandemia COVID, situata energjetike dhe lufta në Ukrainë e kanë kufizuar mundësitë për bashkëpunim në tregjet e

tona kanë plotësuar standardet më të rëndësishme dhe janë gati për të qenë pjesë e tregut të përbashkët evropian. Për kompanitë e BP është e rëndësishme që të hiqen barrierat në biznes me BE, duke i dhënë akses të plotë në tregun BE.

"Një tjetër mekanizëm i rëndësishëm që BP 6 është duke zbatuar, është fondi për bashkëpunim rajonal, i cili mbështet përpjekjet rajonale për përmirësimin e cilësisë të arsimit profesional me qëllim përgatitjen e të rinjve për mundësi punësimi. Dua të përsërisht qeverinë gjermane për mbështetjen në këtë drejtim që na ka akorduar 64.3 milionë



përgjigjet zhvillimeve politike, gjatë proceseve të Berlinit si një stimul tjetër i Ballkanit Perëndimor për t'u bashkuar në BE".

Duke marrë fjalën në Forumin e Ministrave të Ekonomisë me titull, "Tregu i përbashkët rajonal – një hap drejt Tregut Unik të BE", ajo shprehu mirënjohje për kryeministrin Rama që ka marrë iniciativën për këtë forum kaq të rëndësishëm biznesi, që organizohet në Tiranë, në kuadrin e Procesit të Berlinit.

"Shifra e lartë e kompanive nga vendet e rajonit dhe vetë BE-ja është fakt, tregon se sektori i biznesit ka një objektiv të përbashkët për të gjithë ne. Projekti evropian është një projekt me fokus, begatia për Ballkanin Perëndimor është begati për BE", tha Muqostepa.

Sot, vijoi ajo, bashkë me MEDAF grupin e rëndësishëm të biznesit francez, ne do të firmosim memorandumun e bashkëpunimit, ku shprehim interesin e përbashkët për bashkëpunim.

Ajo solli në vëmendje se



përbashkëta.

"Struktura e bashkëpunimit mes BE dhe BP duhet forcuar më tej përpara anëtarësimit të plotë i cili ka të bëjë me pjesën e zgjerimit. Në rajonin tonë kemi potenciale të pasura me burime natyrore që krijojnë mundësi për investime të reja, duke pasur parasysh se BE, është një nga investitorët kryesorë në BP. Ekonomitë tona kanë nevojë për t'u kuptuar më mirë nga partnerët evropianë që të kenë kredibilitetin e duhur për sa i takon këndvështrimin evropian", tha Muqostepa.

Sipas saj, më shumë se 6 mijë kompani nga kompanitë

euro si dhe qeverinë e Zvicrës që ka financuar 10 milionë euro për këtë qëllim", theksoi Muqostepa.

"Përmirësimi i bashkëpunimit rajonal është një nga sfidat kryesore për të gjithë ne për t'i kapërcyer, ne nuk do të ishim konkurrues në treg nëse nuk do të shtonim përpjekjet drejt digjitalizimit dhe heqjes së pengesave të BP, por nga nga tjetër ne duhet të kemi një rrugë të besueshme drejt politikave të BE dhe tregut të përbashkët.

E ardhmja e BP është në BE dhe së shpejti shpresojmë të kemi lajme të mira për bizneset tona", tha Muqostepa.

## Deda: AKU, platformë bashkërendimi për sigurinë ushqimore

Platforma e bashkërendimit me autoritet e linjës për sigurinë ushqimore synon të rrisë angazhimin dhe ndërgjegjësimin e strukturave në të gjitha nivelet për rritjen e sigurisë ushqimore në të gjithë zinxhirin ushqimor.

Përfaqësuesit e institucioneve të linjës zhvilluan takimin mbi platformën e Bashkërendimit të Sigurisë Ushqimore, ku morën pjesë zv/ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Arian Jaupllari, bashkë me kryetarët e bashkive dhe drejtorësh të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Jeta Deda, drejtorin e AKVMB, Rolandi Meçe dhe prefektin e qarkut Shkodër Majlinda Angoni.

Në këtë takim merrnin pjesë edhe drejtorët e Policisë së Qarkut, Policisë kufitare dhe Tatimeve, ku u diskutua

gjerësisht për bashkëpunimin dhe bashkërendimin e strukturave për garantimin e sig-



urisë ushqimore dhe ndërtimin e programeve të përbashkëta ndërgjegjësimi për fermerët, operatorët e biznesit ushqimor dhe peshkatarët.

Gjithashtu në takim u shtruan çështje të rëndësishme për fuqizimin e sektorit të bujqësisë, si

formalizimi, projektet e ujitjekullimit, menaxhimi i tokës, aksesin në tregjet bujqësore dhe markatat e peshkut, shëndeti i bimëve dhe i kafshëve, etj.

## ABA online një risi digjitale në ndihmë të fermerit



Nga një vëzhgim dhe analizë e disa fermave të vogla të gjedhit me rreth 10-15 krerë, u evidentuan disa probleme të cilat janë të lidhura ngushtësisht me strehimin e papërshtatshëm, mungesën e lëvizjes së kafshëve, të ushqyerit e pamjaftueshëm dhe të pabalancuar, higjienën, riprodhimin e prodhimin.

Më konkretisht fermat e marra në analizë përgjithësisht nuk kanë kapacitetin e duhur për strehim, stallat janë të vogla, të paventiluara, me shtrat të papërshtatshëm (përgjithësisht i shkurtër). Grazhdi i lopëve është i papërshtatshëm shpesh i ngushtë dhe i pamjaftueshëm për ushqimin individual të çdo lope.

Në shumicën e rasteve mun-

gon padoku i cili do të mundësonte lëvizjen e kafshëve dhe përmirësimin e shumë parametereve të performancës së tyre e veçanërisht riprodhimit. Të ushqyerit shpesh është i njëanshëm, silazhi i misrit sigurohet vetëm për gjashtë muaj dhe nuk përbën një ushqim gjithëvjetor për tufën. Ka mangësi në rritjen e mëshqerrave pasi nuk ndiqet protokollin për të realizuar ndërhimin e parë si kombinim i moshës 14 muaj dhe peshës rreth 350 kg.

Pirja e ujit realizohet përmes enëve të papërshtatshme, me mundësi të kufizuara për pastrim duke u bërë shkas për shfaqjen e sëmundjeve bakteriale në fermë. Fermeri nuk merr pjesë në vendimmarrje përpara i përket riprodhimit e

përmirësimin racor, ka raste kur mungon mbajtja e shënimeve, nuk njihet materiali i përdorur për inseminim si dhe në ndonjë rast as raca e përdorur.

Shfaqen probleme me një servis periodë (periudha nga pjellja deri në inseminim fekondues ose barrësues) të zgjatur, duke sjellë humbje të konsiderueshme në fermë.

Krahas përpjekjeve që kushtohen për higjienën, ende ka probleme që lidhen me pastërtinë dhe higjienën e stallave, të kafshëve si dhe mos respektimin siç duhet të praktikave të mjeljes.

Për të mësuar më shumë për Rekomandimet për përmirësim, shfletoni aboonline.al (Rubrika Teknologjia e Prodhimit/ Blegtori/ Gjedhi)

## Zv.ministri Kristo: Shqipëria, reforma ambicioze për zhvillimin e peshkimit

Konferenca e nivelit të lartë mbi peshkimin dhe akuakulturën që u zhvillua në Maltë, solli një hap më pranë, sfidat e së ardhmes ku qëndrueshmëria mjedisore, ekonomike dhe sociale, do të nxisin zhvillimin e sektorit në Mesdhe.

Të pranishëm në këtë konferencë ishin zv/ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Ru-

të vëzhguar gjendjen e sektorit vital të peshkimit dhe akuakulturës dhe për të rënë dakord për veprime të reja transformuese drejt një të ardhmeje të qëndrueshme.

Veprimtaria, e organizuar nga qeveria e Maltës dhe e organizuar nga Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun (GFCM) së bashku me Bashkimin Evropian, u

Zv.ministri vuri në dukje se, në nivel kombëtar, Shqipëria ka vënë në lëvizje reforma ambicioze, ligjërish dhe teknikisht, duke përditësuar ligjet dhe rregulloret tona për peshkimin, duke i përfunduar ato me rekomandimet e GFCM siç parashikohet në deklaratë.

Kristo bëri të ditur se, në dritën e kësaj, gjatë sesionit më të fundit të Komitetit të Përputhshmërisë të GFCM, në maj 2023, Shqipëria u promovua nga kategoria 2 e përputhshmërisë në kategorinë 1 të përputhshmërisë.

"Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural do të vijojë bashkëpunimin e mirë në kuadrin e kësaj deklaratë, për të siguruar zhvillimin e sektorit të



ral, Roland Kristo në cilësinë e presidentit të Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun, (GFCM) dhe Arian Palluqi, këshilltar i ministrit si përfaqësues i MBZHR, teksa eventi "MedFish4Ever", mbledhi së bashku zyrtarë të nivelit të lartë nga 20 vende, gjithashtu peshkatarë, fermerë peshku, shkencëtarë, menaxherë, organizata të shoqërisë civile dhe ekspertë të tjerë për

fokusua në progresin që është bërë dhe nevojën për zgjidhje të reja për të adresuar sfidat që janë shfaqur që nga koha e nënshkrimit të Deklaratës Ministrore të MedFish4Ever 2017.

Kristo tha se, "deklarata "MedFish4Ever" u nënshkrua nga qeveria shqiptare në 2017 dhe ka qenë një gur themeli për të vepruar në nivele të ndryshme".

peshkimit dhe akuakulturës së qëndrueshme në vendin tonë", deklaroi zv.ministri, teksa e cilësoi marrëveshjen rajonale të një rëndësie të veçantë vendeve mesdhetare, që vendos një vizion dhjetëvjeçar drejt qëndrueshmërisë dhe mirëqenies së sektorit të peshkimit dhe akuakulturës, si dhe ruajtjen e ekosistemeve të çmuara detare mesdhetare dhe shërbimeve që ato ofrojnë.

## KËNDI I EKSPERTIT

(Vijon nga gazeta nr. 469)

## Krahina e Oparit - Vatër e origjinës së shumë specieve bimore

Përgatitur nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari

**Krahina e Oparit ka shumë pyje ku ndodhen shumë lloje të ndryshme drurësh, nga pyjet e ahut, lisit (Dushkut), pishës, bredhit, panjës, rrobullit, shparthit, mëllëzës, bungës etj., të cilat gjenden aty që në lashtësi dhe janë vendase, duke e bërë krahinën si një nga vatrat e origjinës së tyre.**

**Ahu** (Fagus sylvatica). Në Opar është nga drurët më të



Pylv me drure Ahu

përhapur dhe formon pyje të gjera në lartësitë 800-2000 metra mbi nivelin e detit, si në Sherë, pyjet e Kurorës, Gjergjevicës, Bofjes, Dusharit etj. Druri arrin lartësitë deri 50 metra dhe trashësi trunq deri 2 metra. Druri përdoret kryesisht për dru zjarri, qymyr druri, për vegla dhe objekte të ndryshme. Gjethet duke i prerë së bashku me degëzat e holla përdoren për zaire për dimër për bagëtinë sidomos për dhinë.

**Panja e malit** (Acer pseudoplatanus). Në Opar takohet në pyjet e zonës së ahut dhe rrallë në ato të dushkut, në lartësitë 800-1800 m mbi nivelin e detit. Në pyllin e madh të Gurrë-Mujasit gjendet një vend që quhet Bregu u panjave. Dru i bukur që rritet 35-40 m lartësi dhe trunq me diametër 2-2.5 m. Druri i bardhë përdoret për figurina, orendi shtëpiake.

**Panja fletëgjërë** (Acer obtusatum). Në Opar takohet më dendur në pyjet e përzier të zonës së dushkut dhe më pak në ato të zonës së ngrohtë të ahut, në lartësitë 500-1600 metra nga niveli i detit. Bima arrin lartësi 15-20 metra.

**Krekëza fletëmadhe** (Acer campestre). Në Opar takohet në pyjet fletore dhe ledhe e djerrina përreth fshatrave deri në lartësitë 1200 metra. Pema një dru i vogël me majë të dendur të rumbullakët që arrin lartësi 10-15 metra e trashësi trunq deri 50 cm. Druri përdoret për punime të holla. Gjethet konsumohen nga kafshët gjatë dimrit.

**Ashja** (Ilex aquifolium). Quhet dhe gjëmb ujku ose gjëmb ariu. Në Opar gjendet nga pak në pyjet e zonës së dushkut dhe të ahut në lartësi 900-1600 metra mbi nivelin e detit. Gjendet sidomos në pyjet e Bofjes dhe Dusharit. Dru i vogël me lartësi 6-7 (10) metra, që qëndron vazhdimisht i gjelbër. Përdoret si bimë zbu-

kuruese. Druri shërben për bastunë e orendi speciale, ndërsa gjethet përdoren për qëllime mjekësore.

**Bliri fletësërmhtë** (Tilia tomentosa). Takohet në shpatet e maleve në Opar në lartësitë deri 1300 metra nga niveli i

detit. Bima zhvillon një kurorë të dendur dhe arrin lartësinë 25-30 metra. Lulja e tij shërben si bimë mjekësore për përgatitje çajrash ndërsa druri shërben për mobilje të lehta dhe veshje të brendshme.

**Shkoza e bardhë** (Carpinus betulus). Në krahinën e Oparit gjendet në Moglicë, pyllin e Tudasit e ndonjë vend tjetër. Druri rritet deri 20 metra lartësi dhe 60-80 cm diametër i trunqut. Ka përdorim të gjithanshëm në zdrukhtari.


**Bungëbuta** (Quercus pubescens). Takohet gjithkund në Opar në pllajat e kodrinave dhe të maleve në lartësitë deri 1100 metra mbi nivelin e detit. Druri arrin lartësi 18-20 metra. Një kodër mbi fshatin Zerec në Oparin e Poshtëm thirret "Bunga e Zerecit" (ku me sa duket ka patur shumë drurë të kësaj specie). Aty ka qenë dhe një kishë e fisit të Muzakajve dhe ku sipas Gjon Muzakës janë varrosur pjaardhësit e tyre. Druri përdoret për të përgatitur objekte që kërkojnë dru të fortë. Gjethet përdoren për ushqimin e bagëtisë gjatë dimrit.

**Shparthi** (Quercus Frainetto). Ky dru gjendet në Opar sidomos në Bakullin e Osojës, i cili është shpallur Monument Natyre. Bima arrin lartësi 35-40 metra dhe trashësi trunq 80-90 cm. Druri përdoret për shtylla e tranvera dhe përgatitjen e veglave bujqësore. Gjethet dhe lendet e tij përdoren për ushqimin e bagëtive.

**Plepi i egër**. (Populus tremula). Në Opar takohet në pyje ose rrëzë tyre, nëpër përrenj ose shpate apo shkëmbinj deri në lartësinë 2000 metra mbi nivelin e detit. Rritet zakonisht në lartësi 10-15 metra por që mund të shkojë dhe deri 30 metra, ka ngjyrën e lëvore së trunqut hiri të errët dhe degëzat ngjyrë ulliri me lenticela. Përdoret për përgatitjen e ambalazheve të ndryshme (arka, ko-

sha) dhe shkrepseve.


**Vidhi** (Ulmus foliacea). Në Opar ky lloj druri gjendet në buzë ujrash e rrëzë pyjeve deri në 1500-1600 metra lartësi mbi det. Pema është një dru i bukur që rritet 30-40 metra lartësi dhe trunq me trashësi 80-150 cm. Druri i tij përdoret për karroca dhe mobilje e orendi zbukurimi. Gjethet përdoren për ushqimin e bagëtisë ndërsa goglat përdoren për industrinë e lëkurëve si regjës.



Disa nga llojet e drurëve pyjorë që gjenden në Krahinën e Oparit. 1.Panja e malit 2.Panja fletëgjërë 3.Krekëza fletëmadhe 4.Ashja 5.Bliri fletësërmhtë

**Bredhi i bardhë** (Abies alba). Druri më i bukur i vendit tonë. Takohet shpesh në zonën e ahut në grumbuj dhe pyje të përzjerë me ah në lartësitë 1000-1650 m mbi nivelin e detit në ahishtet e Gorës dhe Oparit, si në Bofje, Sherë, Pyllin e Gjergjevicës, Pasha Tepe dhe pyje të veçanta si Plepshta dhe pyjet e rinj në Mogilë. Druri rritet 40-50 m lartësi dhe 2 m diametri i trunqut. Përdoret në mobileri dhe ndërtim si material i lehtë.

**Pisha e zezë** (Pinus nigra). Një nga drurët më të përhapur në vendin tonë. Takohet në nënzonën e flohtë të dushqeve dhe nënzonën e ngrohtë të ahut dhe bredhave mesdhetarë ku formon pyje të gjërë e të bukur dhe në Opar. Druri arrin lartësi 40-50 m dhe trunq 2.5 - 3 m diametër. Përdoret si lëndë ndërtimi e punimi, shtylla, tranvera etj. Shfrytëzohet dhe për



Disa nga llojet e drurëve pyjorë që gjenden në Krahinën e Oparit. 1.Shkoza e bardhë 2.Bungëbuta 3.Shparthi 4.Plepi i egër 5.Vidhi 6.Bredhi i bardhë 7.Pisha e zezë 8.Mëllëza

rëshirën e saj cilësore.

**Mëllëza** (Ostrya carpinifolia Scop.)

Dru që rritet deri 20 metra lartësi me lëvore të trunqut të murrme në të kuqërremtë. Gjethet e këmbryera, ovale


4-10 cm të gjata, Lulet mashkullore veshul i zgjatur 4-8 cm të gjata, Fruti akenë 4-8 cm e mbështjellë me luspa. Kjo specie është e përhapur në Oparin e Poshtëm, në mali i Mollës mbi fshatin Peshtan etj.

**Rrobulli** (Pinus Heldreichi Crist.) Është i ngjashëm me pishën e zezë dhe shkon 20-25 metra lartësi dhe 1.5 m diametër të trunqut me kurorë piramidale. Gjethet fijore, dy nga dy 6-8 cm të gjata. Boçet

bagëtisë së imët gjatë verës.

Bimësia e këtyre kullotave përbëhet nga bimë të ndryshme barishtore dhe kryesisht bimë graminore, leguminoze dhe lloje të tjera bimësh. Këto bimë gjenden aty prej mijra vjetësh në gjendje të egër dhe janë bimë vendase dhe kjo tregon edhe njëherë për faktin se Krahina e Oparit është një nga vatrat e origjinës së këtyre specieve bimore.

## Bimët e egra graminore



Bimët e egra graminore të Oparit. 1.Egjerat (Lolium perenne) 2.Kokëmadhi (Phalaris sp.) 3.Festuka (Festuca pratensis) 4.Grami (Cynodon dactylon) 5.Daktili (Dactylis glomerata) 6. Bishtdhelpra. (Alopecurus sativa) 7. Bisht miu (Bromus inermis) 8. Tërshëra e egër. (Avena fatua) 9. Poa ose Bari i hollë (Poa pratensis). 10. Bisht mace (Phleum pratense)

simetrike 4-8 cm të mëdha. Rritet mirë në majat e maleve 1600-2200 metra mbi nivelin e detit. Druri i tij është i cilësisë më të mirë dhe që i qëndron lagështisë prandaj përdoret për kade dhe vozat e verës.

## Në Krahinën e Oparit gjenden sipërfaqe masive të

të Oparit. Përveç kullotave këto bimë gjenden dhe vende të zhveshura, të thata dhe shkëmbore, me të cilat është e mbushur plot Krahina e Oparit. Nga bimët barishtore më të përhapura janë graminoret e egra, të përhapura sidomos në kullotat alpine, leguminozet (grashinat), gjëmbat, sinapi,

celat e grurit dhe bimët e tyre janë shumë të ngjashme. Kokëmadhi (Phalaris sp.) Festuka (Festuca pratensis). Bimë shumë vjeçare në kullota. Rritet 30-100 cm lartësi. Grami (Cynodon dactylon) Bimë barishtore graminore që shtohet me rizoma dhe arrin lartësi deri 30 cm. Daktili. (Dactylis glomerata), njohur edhe si këmba e këndezit, një specie e zakonshme e barit që rritet 15-140 cm. Bishtdhelpra. (Alopecurus sativa). Bar i kullotave, bimë shumëvjeçare bari i përket familjes barishteve (Poaceae). kultivohet për kullotje dhe bar të thatë (sanë). Bimët arrijnë lartësi deri 110 cm. Bisht miu (Bromus inermis). Bimë 1-2 vjeçare, të mbuluara me qime. Ajo mund të rritet në 10 dhe 100 cm e lartë, ndonjëherë në tufa, nganjëherë në formë individuale. Ka nga 2 deri në 5 nyje. Gjethet janë gri-jeshile. Tërshëra e egër (Avena fatua). Bimë e ngjashme me tërshërn e kultivuar por mbin në pacelat e mbjella me drithra

dhe infektin ato duke ulur prodhimin e tyre dhe cilësinë e tij. Poa ose Bari i hollë (Poa pratensis). Poa pratensis është një bimë me vlerë e kullotave. Poa pratensis është një bimë barishtore shumëvjeçare 30-70 cm e gjatë. Gjethet kanë formë, të ngushtë-lineare, deri në 20 centimetra gjatë dhe 3-5 milimetra të gjera, të butë ose pak të ashpër. Bisht mace (Phleum pratense). Bimë livadhore shumëvjeçare. Ajo rritet në 50-150 cm e gjatë, me gjethe deri në 42 cm të gjatë dhe 1.7 cm të gjerë. Gjethet janë pa push, dhe në pjesën e poshtme kthehet të ngjyrë kafë të errët. Përdoret për ushqimin e gjedhit dhe sidomos të kua-jeve.

**Bimët e egra leguminoze të Oparit.** Në kullotat e Oparit gjenden dhe shumë bimë leguminoze të egra që përbëjnë një element tjetër të cilësisë së barit të këtyre kullotave. Nga këto bimë mund të përmendim grashinat, lotuset, bizelja e egër, trëndelina etj.

**Grashinat** (Vicia sativa), janë bimë bishtajore që fiksojnë azotin e ajrit në familjen Fabaceae. Ato janë vendase në

(Vijon në faqen 14)





Kredi Agrobiznes 

A mund të blej makineri dhe  
pajisje të reja bujqësore?

*SIGURISHT,  
BËHET!*



 **CREDINS bank**

[www.bankacredins.com](http://www.bankacredins.com)

Tel.: +355 4 53 53 000

